

LIGJ
Nr.10 251, datë 11.3.2010

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUASË DHE PROJEKTIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE, E
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SH.A., SI AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“LINJA UNAZORE 110 KILOVOLT E SHQIPËRISË SË JUGUT”, NËPËRMJET NJË
HUAJE PREJ 500 000 EUROSH**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huasë dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit “Linja unazore 110 kilovolt e Shqipërisë së Jugut”, nëpërmjet një huaje prej 500 000 (pesëqind mijë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6480, datë 25.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

HUAJE DHE PROJEKTI DATË DHJETOR 2009 NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN
(KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE
(HUAMARRËSI) DHE OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA (OST) (AGJENCIA
E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 500,000 EURO (PESËQIND MIJË EURO) LINJA UNAZORE
110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT

PREAMBULË

Mbi bazën e një marrëveshjeje që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Gjermane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (Marrëveshje Qeveritare), Huamarrësi, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja lidhin këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti:

Huaja që jepet sipas kësaj Marrëveshje huaje dhe projekti është pjesë përbërëse e një pakete për të financuar projektin “Linja unazore 110-kV të Shqipërisë së Jugut”. Dy hua të tjera që do të jepen nga KfW-ja në një shumë deri në 37,750,000 euro dhe në një shumë deri në 10,750,000 euro sipas dy marrëveshjeve të veçanta huaje dhe projekti ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit (marrëveshjet plotësuese të huasë) do të plotësojnë paketën si pjesë përbërëse (kjo Marrëveshje e huasë dhe projektit dhe marrëveshjet plotësuese të huasë, së bashku “Marrëveshjet e huasë”).

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i huasë

1.1 KfW-ja i jep Huamarrësit një Hua që nuk kalon 500,000.00 euro.

1.2 Huamarrësi e kanalizon huanë plotësisht tek agjencia e zbatimit të projektit, në pajtim me kushtet e parashtruara në nenin 2. Agjencia e zbatimit të projektit përdor huanë përjashtimisht për linjën unazore 110-kV të Shqipërisë së Jugut (projekti), dhe kryesisht për të paguar shpenzimet e këmbimit të huaj. Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton detajet e projektit dhe mallrat e shërbimet që financohen nga huaja me marrëveshje të veçantë, që bihet dakord nga Huamarrësi.

1.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike mbulohen nga Huamarrësi ose agjencia e zbatimit të projektit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga huaja.

Neni 2

Kanalizimi i huasë tek agjencia e zbatimit të projektit

2.1 Huamarrësi e kanalizon huanë tek agjencia e zbatimit të projektit në bazë të një marrëveshjeje të kanalizimit të huasë me termat dhe kushtet e parashtruara në nenet 4.2 dhe 4.4 të kësaj.

2.2 Para disbursimit të parë të huasë, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së huasë të përcaktuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i huasë nuk përbën ndonjë përgjegjësi të agjencisë së zbatimit të projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti.

Neni 3

Disbursimi

3.1 KfW-ja disburson huanë në pajtim me progresin e projektit dhe me kërkesë të agjencisë së zbatimit të projektit. Me marrëveshje të veçantë, agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja bien dakord për një procedurë disbursimi, veçanërisht mbi provat që provojnë se shumatat e kërkuara të huasë janë përdorur për qëllimin e përcaktuar, që miratohen nga Huamarrësi.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë disbursimin pas datës 30.12.2013.

Neni 4

Tarifa e angazhimit, interesi dhe shlyerja

4.1 Huamarrësi paguan një tarifë angazhimi prej 0.25% vjetor mbi shumatat e padisbursuara të huasë. Tarifa e angazhimit llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që mbaron në datën kur debitoen disbursimet.

4.2 Huamarrësi paguan interesin mbi huanë në një normë prej 2% vjetor. Interesi kërkohet nga datat në të cilat debitoen disbursimet deri në datat kur kreditohen shlyerjet në llogarinë e KfW-së e përcaktuar në nenin 4.9

4.3 Huamarrësi paguan tarifën e angazhimit, interesin dhe çdo interes mbi pagesat e prapambetura në pajtim me nenin 4.5 dy herë në vit, më 30 qershor dhe 30 dhjetor për gjysmën e vitit që mbaron. Tarifa e parë e angazhimit paguhet së bashku me pagesën e parë të interesit.

4.4 Huamarrësi shlyen huanë si më poshtë:

Kësti	Datë		Shuma	
1	30 qershor	2020	12.000,00	euro
2	30 dhjetor	2020	12.000,00	euro
3	30 qershor	2021	12.000,00	euro

4	30 dhjetor	2021	12.000,00	euro
5	30 qershor	2022	12.000,00	euro
6	30 dhjetor	2022	12.000,00	euro
7	30 qershor	2023	12.000,00	euro
8	30 dhjetor	2023	12.000,00	euro
9	30 qershor	2024	12.000,00	euro
10	30 dhjetor	2024	12.000,00	euro
11	30 qershor	2025	12.000,00	euro
12	30 dhjetor	2025	12.000,00	euro
13	30 qershor	2026	12.000,00	euro
14	30 dhjetor	2026	12.000,00	euro
15	30 qershor	2027	12.000,00	euro
16	30 dhjetor	2027	12.000,00	euro
17	30 qershor	2028	12.000,00	euro
18	30 dhjetor	2028	12.000,00	euro
19	30 qershor	2029	12.000,00	euro
20	30 dhjetor	2029	12.000,00	euro
21	30 qershor	2030	13.000,00	euro
22	30 dhjetor	2030	13.000,00	euro
23	30 qershor	2031	13.000,00	euro
24	30 dhjetor	2031	13.000,00	euro
25	30 qershor	2032	13.000,00	euro
26	30 dhjetor	2032	13.000,00	euro
27	30 qershor	2033	13.000,00	euro
28	30 dhjetor	2033	13.000,00	euro
29	30 qershor	2034	13.000,00	euro
30	30 dhjetor	2034	13.000,00	euro
31	30 qershor	2035	13.000,00	euro
32	30 dhjetor	2035	13.000,00	euro
33	30 qershor	2036	13.000,00	euro
34	30 dhjetor	2036	13.000,00	euro
35	30 qershor	2037	13.000,00	euro
36	30 dhjetor	2037	13.000,00	euro
37	30 qershor	2038	13.000,00	euro
38	30 dhjetor	2038	13.000,00	euro
39	30 qershor	2039	13.000,00	euro
40	30 dhjetor	2039	13.000,00	euro

4.5 Nëse një kësht shlyerjeje nuk është në dispozicion të KfW-së kur është për t'u paguar KfW-ja, mund të rritë normën e interesit për pagesat e prapambetura me normën bazë plus 3% vjetor për periudhën që fillon në datën e caktuar dhe përfundon në datën në të cilën kreditohen këto pagesa në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 4.9. “Norma Basë” është norma e interesit e deklaruar nga Deutsche Bundesbank si norma bazë në normën e zbatueshme në datën përkatëse të caktuar. Në rast të

pagesave të prapambetura të interesit, KfW-ja mund të kërkojë zhdëmtim. Ky zhdëmtim nuk kalon shumën që arrihet nëse kërkohet interes mbi këto pagesa të prapambetura të interesit në normën bazë që mbizotëron në datën e caktuar plus 3% vjetor.

4.6 Tarifa e angazhimit, interesi dhe çdo tarifë tjetër mbi pagesat e prapambetura në pajtim me nenin 4.5 llogariten mbi bazën e vitit me 360 ditë dhe muaj me 30 ditë.

4.7 Shumat e huasë të padisbursuara ose të paguara paraprakisht kreditohen në pjesë të barabarta kundrejt kësteve të pashlyera, përveç kur KfW-ja, me zgjedhjen e saj, përcakton një mënyrë tjetër kompensimi në një rast të caktuar, veçanërisht në rastin e shumave të janë volume më të vogla.

4.8 KfW-ja ka të drejtë të kreditojë, me zgjedhjen e saj, pagesat e marra kundrejt pagesave për t'u paguar në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti ose në bazë të marrëveshjeve të tjera të huasë të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

4.9 Huamarrësi i dërgon të gjitha pagesat në euro në llogarinë e KfW-së nr.3102560801 në KfW, Frankfurt am Main (BLZ 500 204 00, SWIFT: KFWIDEFF) me informacionin shtesë "Ref.vvvvmmdd" si referencë; nuk lejohet asnjë kompensim i kundër-pretendimeve ndaj këtyre pagesave.

Neni 5

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja e parakohshme

5.1 Huamarrësi, në çdo kohë,:

a) në pajtim me përmbushjen e detyrimeve sipas nenit 8, mund të anulojë çdo shumë huaje që nuk është disbursuar, dhe

b) mund të shlyejë Huanë plotësisht ose pjesërisht para maturimit.

5.2 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Huamarrësi nuk ka përmbushur detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur janë për t'u paguar;

b) detyrimet në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti ose në bazë të marrëveshjeve të veçanta sipas kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti janë shkelur;

c) agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huasë janë përdorur për qëllimin e përcaktuar, ose

d) dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e projektit, ose përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti.

5.3 Nëse ka ndodhur një nga situatat e përcaktuara në nenin 5.2 "a", "b" ose "c" dhe nuk është eliminuar për një periudhë të caktuar nga KfW-ja, që, megjithatë, ka ekzistuar të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 "a" ose 5.2 "b", mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të prapambetura të huasë, si dhe pagesën e të gjithë interesit të mbledhur dhe të gjitha tarifat e rastësishme;

b) në rastet e përcaktuara në nenin 5.2 "c", mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave të huasë që agjencia e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 6

Kostoja dhe detyrimet publike

6. Huamarrësi bën të gjitha pagesat që duhet të bëhen në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti pa asnjë zbritje për tatimet, detyrimet e tjera publike apo shpenzime të tjera dhe paguan koston e transfertës ose të konvertimit që mbliidhen në lidhje me disbursimin e huasë.

6.2 Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti.

Neni 7

Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti dhe përfaqësimi

7.1 Në momentin e duhur para disbursimit të parë, Huamarrësi i jep prova të pranueshme

KfW-së që provojnë që Huamarrësi i ka përmbushur të gjitha kërkesat në pajtim me ligjet e tij kushtetuese dhe të tjera për përgjegjësinë e vlefshme ndaj të gjithë detyrimeve të tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti.

7.2 Ministri i Financave dhe ata persona të tjerë që përcaktohen prej tij ose prej saj për KfW-në dhe të autorizuar nga ekzemplarët e firmave të certifikuara prej tij ose saj përfaqëson Huamarrësin në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti. Drejtori i përgjithshëm i agjencisë së zbatimit të projektit dhe persona të tjera që përcaktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga ekzemplarët e firmave të certifikuar prej tij ose saj përfaqësojnë agjencinë zbatuese të projektit në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti. Kompetencat e përfaqësimit nuk mbarojnë deri sa të merret nga KfW-ja revokimi i tyre i shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar i kohës.

7.3 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje huaje ose projekti dhe çdo njoftim dhe deklaram i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaram i tillë konsiderohet i marrë nëse ai ka arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në një adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse që i njoftohet palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në: KfW
Department L III a 3
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Ministria e
Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit" nr.1,
Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 2228405
Fax: +355 4 2228494

Për agjencinë e zbatimit të
projektit: Operatori i Sistemit të
Transmetimit (OST) sh.a.
Bulevardi "Gjergj Fishta" nr.10
Tiranë
Shqipëri
Tel: +355 4 2225581
Fax: +355 4 2225581

7.4 Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje të huasë dhe projektit që prekin vetëm marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovimin e agjencisë së zbatimit të projektit.

Neni 8 Projekti

8.1 Agjencia e zbatimit të projektit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe mirëmban projektin në pajtim me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike dhe në thelb në pajtim me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) ia cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e projektit konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimit të projektit firmave të kualifikuara;

c) ua jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja me ofertim paraprak ndërkombëtar konkurrues;

d) mirëmban ose merr masa për mirëmbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartësisht koston e mallrave dhe shërbimeve që kërkojnë nga projekti dhe që identifikojnë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat në fjalë, si dhe çdo e të gjithë dokumentacionin tjetër të rëndësishëm për zbatimin e projektit dhe për të vizituar projektin dhe të gjitha impiantet në lidhje me të;

f) t'i japë KfW-së çdo informacion tjetër dhe raportet mbi projektin dhe përparimin e tij të mëtejshëm siç mund të kërkojë nga KfW-ja; dhe

g) i paraqet KfW-së pa vonesë çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi nga OECD-ja dhe anëtarët e saj në bazë të së ashtu-quajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të përbashkëta" pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja dhe bashkërendon përgjigjen e secilës prej këtyre pyetjeve për KfW-në.

8.2 Agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë që i përkasin nenit 8.1 në një marrëveshje të veçantë.

8.3 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit:

a) siguron financimin e plotë të projektit dhe, me kërkesë, i jep KfW-së prova që provojnë mbulimin e kostove që nuk paguhen nga huaja; dhe

b) me iniciativën e tyre njoftojnë KfW-në për çdo rrethanë tjetër që pengon ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin dhe qëllimin e projektit.

8.4 Huamarrësi asiston agjencinë e zbatimit të projektit në pajtim me praktikën e shëndosha financiare dhe inxhinierike në zbatimin e projektit dhe në përmbushjen e detyrimeve të agjencisë së zbatimit të projektit sipas Marrëveshjes së huasë dhe projektit dhe, veçanërisht, i jep agjencisë së zbatimit të projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit.

8.5 Për transportin e mallrave që financohen nga huaja zbatohen dispozitat e Marrëveshjes qeveritare që janë të njohura për Huamarrësin.

Neni 9 Dispozita të ndryshme

9.1 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, dhënien e çdo kontrate për furnizime dhe shërbime që financohen dhe me kërkimin e disburseve të shumave të huasë nuk kërkojnë, prezumojnë, japin, sigurojnë, premtojnë apo marrin ndonjë premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

9.2 KfW-ja ka të drejtë t'i japë Republikës Federale të Gjermanisë informacion në lidhje me lidhjen dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së huasë dhe projektit. Si KfW-ja, dhe Republika Federale e Gjermanisë kanë të drejtën t'u kalojnë informacion mbi huanë dhe projektin duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga huaja organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me aspektet e shërbimit të borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në lidhje me dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja. E drejta e mësipërme për t'u dhënë informacion organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për t'u dhënë informacion të tillë edhe anëtarëve të këtyre organizatave.

9.3 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të paprekura. Çdo boshllëk që rrjedh nga kjo plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e Marrëveshjes së huasë dhe të projektit.

9.4 Huamarrësi dhe agjencia e zbatimit të projektit nuk mund të caktojë ose transferojë, rëndojë me peng ose hipotekë pretendimet nga Marrëveshja e huasë dhe projektit.

9.5 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje huaje dhe projekti mbarojnë pas pesë vjetësh nga mbarimi i vitit në të cilin kanë rrjedhur këto pretendime dhe në të cilin KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që caktojnë këto pretendime ose mund të ketë marrë dijeni për to në mungesë të neglizhencës së plotë.

9.6 Kjo Marrëveshje e huasë dhe projektit rregullohet nga ligji i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i realizimit është Frankfurt am Main.

9.7 Të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje të huasë dhe projektit zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që caktohen dhe veprojnë në pajtim me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të zbatueshme herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh zhvillohet në Frankfurt mbi Main. Gjykimi mbahet në gjuhën angleze.

9.8 Marrëveshja e huasë dhe projektit nuk hyn në fuqi dhe vepron derisa të kenë hyrë në fuqi dhe veprojnë: (i) Marrëveshja qeveritare mbi të cilën bazohet dhe (ii) marrëveshjet plotësuese të huasë dhe projektit.

Kjo Marrëveshje huaje dhe projekti përpilohet në tre kopje origjinale, në gjuhën angleze.

Tiranë, dhjetor 2009

KfW

Republika e Shqipërisë
përfaqësuar nga Ministria e Financave,
përfaqësuar nga Ministri

.....

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
Bulevardi "Gjergj Fishta" nr.10
Tiranë
Shqipëri

Dr. Jens Drillisch
Tona.: DJ
Tel: ++49 69 7431-9705
email: jens.drillisch@KfW.de
Datë: dhjetor 2009

L III a3 Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë
Linja unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
500,000 euro nr BMZ: 2006.65.505
Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huasë dhe projektit të datës dhjetor 2009

Të dashur zotërinj,

Në pajtim me Marrëveshjen e huasë dhe projektit të lidhur ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. (Agjencia Zbatuese e Projektit) dhe KfW-së (KfW) të datës ____ dhjetor 2009, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2:

detajet e projektit si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga Huaja;

Në pajtim me nenin 3.1:

procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë se shumtat e disbursuara të huasë përdoren për qëllimin e përcaktuar;

Në pajtim me nenin 8.2:

detajet që i përkasin nenit 8.1 (Zbatimi i projektit).

Ne propozojmë që të bihet dakord për sa më poshtë:

I. Plani i projektit

1. Detajet e projektit

Projekti ka të bëjë me ndërtimin e linjës unazore 110-kV të Shqipërisë së Jugut. Qëllimi i projektit është përmirësimi i furnizimit sasior dhe cilësor me energji elektrike në Shqipërinë e Jugut dhe reduktimi i dëmtimit global dhe lokal i mjedisit. Kjo kontribuon në forcimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në Shqipërinë e Jugut dhe për mbrojtjen klimaterike. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e projektit dhe aktivitetet e kërkuara të projektit, si dhe detyrimet mbi të cilat mbështetet qëllimi i projektit dhe rezultatet e projektit gjenden në aneksin 1.

Plani i projektit është bazuar në studimet e parafizibilitetit “Projekti i transmetimit të energjisë në juglindje” dhe “Projekti i transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë në jugperëndim” vënë në dispozicion të KfW-së, Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit nga marsi i vitit 2006, dhe mbi marrëveshjet e lidhura ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe agjencisë së zbatimit të projektit gjatë vlerësimit të projektit lokal.

Aktivitetet e mëposhtme të projektit financohen nga huaja: një linjë e re 110-kV nga Babica në Sarandë, fuqizimi i nënstacioneve në Babicë dhe Sarandë, lidhjet 110-kV të Orikumit dhe Himarës me linjën e porsa ndërtuar 110-kV, rikonfigurimi i dy rrjeteve të shpërndarjes, linja e re 110-kV nga Erseka – Përmet, Korçë – Ersekë, dhe Përmet – Këlcyrë – Memaliaj; shtrirjen e nënstacioneve në Përmet, Ersekë, Korçë, Këlcyrë, dhe Memaliaj, fuqizimin e nënstacionit të Zemblakut, dhe ndërtimin e një linje 110-kV nga Zemblak-Korçë. Sipas rastit, fondet e mbetura përdoren për investimet e nevojshme në pajisjet e tensionit të lartë.

2. Grafiku kohor

Grafiku kohor përkatës për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e projektit gjendet në aneksin 2.

3. Kostoja e përgjithshme dhe financimi

Kostoja e përgjithshme e parashikuar e projektit (Kostoja e përgjithshme) ku mbështetet vlerësimi i projektit është afërsisht 51,700, 000 euro. Shuma e huasë është 49, 000, 000 euro.

Huaja jepet në bazë të Marrëveshjes së huasë dhe projektit deri në 500 000 euro si një pjesë përbërëse e një pakete për të financuar projektin “Linja unazore 110-kV e Jugut të Shqipërisë”. Dy hua shtesë që do të jepen nga KfW-ja në një shumë deri në 37, 750, 000 euro dhe në një shumë deri në 10,750, 000 euro sipas dy marrëveshjeve të veçanta huaje dhe projekti ndërmjet KfW-së, Huamarrësit dhe agjencisë zbatuese të projektit (Marrëveshje plotësuese e huasë) plotësojnë paketën si pjesë përbërëse (kjo Marrëveshje e huasë dhe projektit dhe marrëveshjet plotësuese të huasë së bashku “Marrëveshjet e huasë”).

Përbërja e koston së përgjithshme dhe plani i financimit gjenden në aneksin 3.

Për disbursimet e shumës së huasë shih aneksin 6.

4. Ndryshimet në planin e projektit

Çdo ndryshim i konsiderueshëm në planin e projektit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së. Agjencia e zbatimit të projektit informon KfW-në për këtë menjëherë, duke deklaruar shkaqet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimit (duke përfshirë koston e përgjithshme). Zbatimi i këtyre masave fillon vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

II. Zbatimi i projektit

1. Përgjegjësitë dhe grafiku i kohës, koston dhe financimit

1.1 Agjencia zbatuese e projektit është përgjegjëse për zbatimin e projektit. Agjencia e zbatimit të projektit ngre një njësi të veçantë për zbatimin e projektit (PIU), që ngrihet dhe është përgjegjëse për zbatimin e projektit deri në dorëzimin përfundimtar.

1.2 Grafiku i detajuar i kohës, koston dhe financimit, i përditësuar rregullisht për zbatimin e përshtatshëm teknik dhe financiar të projektit, përgatitet sa më shpejt të jetë e mundur nga agjencia e zbatimit të projektit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqitet KfW-së. Ky grafik tregon, me afate dhe shuma, ndërlidhjen e parashikuar kronologjike të aktiviteteve të projektit dhe kërkesat

përkatëse financiare. Nëse një shmangie nga ky grafik bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, KfW-së dhe Huamarrësit i jepet një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Detyrat e konsulentit përbëhen nga:

Faza 1a: Faza paraplanifikimit:

a) Rishikimi i konceptit teknik, mbledhja e të dhënave dhe rishikimi i të gjitha të dhënave të disponueshme, informacioni dhe planet në lidhje me nënstacionet ekzistuese dhe të planifikuara 110-kV (diagramet, projektet e ndërtimit, dokumentet planifikuese dhe vizatimet e hollësishme të impianteve) dhe linjat e planifikuara të transmetimit 110-kV, si dhe impiantet e tjera të kërkuara/ekzistuese të përshkruara në kapitullin 1.3 të këtyre termave.

b) Riformim i vizatimeve që mungojnë që kërkohen për zbatimin e projektit dhe përgatitjen e kopjeve të riprodhueshme.

c) Shqyrtimi i gjendjes teknike të impianteve ekzistuese dhe përgatitja e një vështrimi të përgjithshëm të këtyre impianteve dhe strukturave që duhet të mbahen.

d) Asistenca për OST-në në drejtimin e linjës 110-kV duke përfshirë vendndodhjen e kullave të këndeve dhe kabllot ushqyes shtesë në nën-stacionet ekzistuese dhe pajisjet e tjera.

e) Specifikimet e masave të projektit, duke marrë parasysh çdo ndryshim që mund të ketë ndodhur.

f) Përgatitja e planifikimit paraprak dhe grafiku kohor i furnizimeve dhe shërbimeve, d.m.th. paraqitja e një raporti të plan projektit që duhet të përpilohet në mënyrë të tillë që mund të përdoret (të paktën pjesërisht) drejtpërdrejt për qëllime tenderimi.

g) Rishikimi i llogaritjes së kostos dhe përditësimi i parashikimit të kostos së investimeve bazuar në informacionin më të fundit që disponohet.

h) Mbështetja e PIU-t në procesin e marrjes së lejeve dhe licencave të kërkuara.

i) Konsulencë për agjencinë zbatuese të projektit në lidhje me sigurimin e të drejtave të përdorimit të rrugës dhe të tokës, si dhe kompensimet e paguara nga agjencia e zbatimit të projektit (sipas rastit).

j) Mbështetja e PIU-t në përpilimin e një vlerësimi të impaktit mjedisor në pajtim me kërkesat shqiptare dhe standardet ndërkombëtare për të marrë lejen për ndërtimin e linjave ajrore dhe artikuj të tjerë nga autoritetet përkatëse (sipas rastit).

k) Së bashku me PIU-n: përpilimi i konceptit të zbatimit dhe grafikut kohor të zbatimit dhe grafikut të kostos dhe financimit për programin.

Faza 1b: Rishikimi dhe përgatitja e tenderit, procedura e tenderit

l) Në bashkëpunim me PIU-n: rishikimi dhe ndryshimi, sipas rastit, të dokumenteve të tenderit për mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë termat dhe kushtet standarde për tenderat, vlerësimin e sasive, përshkrimin teknik të pajisjeve dhe impianteve dhe një projekt kontratë për furnizimin dhe punimet mbi bazën e rregullave FIDIC.

m) Mbështetje për PIU-n gjatë periudhës së tenderit për të asistuar në përzgjedhjen e kontraktuesit të përgjithshëm, duke përfshirë përgatitjen e njoftimit për tender, organizimin e një vizite të detyrueshme në terren, përgjigjet për pyetjet mbi tenderin, pjesëmarrjen në hapjen e tenderit, përpilimi i protokollit të hapjes së tenderit dhe shërbime të tjera përkatëse për procedurën e tenderit në pajtim me kuadrin ligjor në Shqipëri.

n) Bashkëpunim me PIU-n si drejtuese e vlerësimit të tenderit, përgatitja e raportit të vlerësimit të ofertës dhe paraqitja e tij tek PEA dhe KfW-ja.

o) Formulimi i njoftimit për rekomandimin e dhënies së kontratës.

p) Mbështetja e PEA-s për lidhjen e kontratës së furnizimit dhe punimeve me kontraktuesin e përgjithshëm.

q) Mbështetja e PEA-s në përgatitjen e raportit final të vlerësimit.

Faza 2: Auditimi teknik dhe mbikëqyrja e vendit, përfundimi i projektit

r) Organizimi i një takimi fillimi me aktorët përkatëse dhe autoritetet gjatë të cilit do të prezantohet projekti.

s) Organizimi i takimeve periodike koordinuese me klientin dhe kontraktuesin dhe raporti në këto mbledhje, sipas rastit dhe në pajtim me formatin e rënë dakord.

t) Monitorimi i respektimit rigoroz nga kontraktuesi i grafikut kohor të ndërtimit të miratuar.

u) Këshillimi i OST-së për të dhënë lejet dhe të drejtat e rrugëve që kërkohen nga kontraktuesi

që të respektohet grafiku kohor i miratuar.

v) Miratimi i plan projekteve dhe pjesëmarrja në testet e pranimit të fabrikimit të pajisjeve në pajtim me rregulloret e miratuara dhe standardet dhe veprimet diskrecionare të zakonshme bazuar në eksperiencën profesionale.

w) Mbikëqyrja e cilësisë së punimeve të ndërtimit dhe instalimit, si dhe të furnizimeve dhe shërbimeve të kontraktuesit të përgjithshëm nëpërmjet një përfaqësimi të përshtatshëm në vend.

x) Përgatitja e një planprojekti të detajuar për ndërlidhjen e pajisjeve të reja elektrike me pajisjet elektrike ekzistuese. Përgatitja e kushteve dhe kriterëve për ndërlidhjen, me specifikimet, llogaritjet, diagramet, skemat dhe vizatimet për pajisjet që ndërlidhen drejtpërdrejt. Mbikëqyrja e punimeve të çmontimit dhe prishjes në lidhje me rikonfigurimin e rrjetit, sipas rastit.

y) Asistenca në mbikëqyrjen e kostos së projektit dhe shqyrtimi i faturave të kontraktuesit të përgjithshëm.

z) Monitorimi i programit të trajnimit nga personeli i PEA/PIU-t.

aa) Mbështetja e PEA/PIU-t në përpilimin e një koncepti të operacioneve dhe mirëmbajtjes.

bb) Asistenca në monitorimin e autorizimit dhe fillimin e operimit tregtar.

cc) Komenti dhe mbikëqyrja e aktiviteteve trajnuese, që Kontraktuesi duhet të japë për personelin e OST-së brenda objektit të kontratës.

dd) Asistenca e OST-së në përgatitjen e raporteve semestrale mbi zbatimin e projektit, duke përfshirë përshkrimet e vështirësive që kanë dalë dhe masat që duhet të merren për zgjidhjen e këtyre vështirësive.

ee) Shërbimet e rastësishme dhe të paparashikuara të konsulencës gjatë “periudhës së përgjegjësisë së defekteve” të pajisjeve të energjisë elektrike (punimet).

ff) Asistenca e OST-së në përpilimin e një raporti vlerësimi përfundimtar në lidhje me zbatimin e projektit.

Për detajet e shërbimeve të konsulencës shihni kontratën e konsulencës së nënshkruar.

2.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit ka caktuar Konsulentin Fichtner GmbH&Co. KG me ofertë ndërkombëtare publike, konkurruese, me Kontratën që është nënshkruar më 29 shtator 2009. Faza 1 e kontratës me konsulentin përbën planifikimin e detajuar dhe asistencën në tenderimin e mallrave dhe shërbimeve dhe financohet nga fondet shtesë të grandit të një fondi të veçantë të Qeverisë Gjermane. Faza 2 (mbikëqyrja e zbatimit të punimeve dhe përfundimit të projektit) është kontraktuar në mënyrë fakultative dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huasë dhe Projektit në këtë marrëveshje të veçantë. Faza 2 do të financohet në kuadrin e Marrëveshjeve të huasë dhe projektit.

2.3 Në rast se zgjidhet një konsulent i ri, pas ofertimit përzgjedhës paraprak dhe ndërkombëtar publik konkurrues, kontrata i jepet një konsulenti të pavarur të kualifikuar. Procedura e dhënies së kontratës rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 4), që përbën pjesë integrale të kësaj.

2.4 Nëse është i nevojshëm, në njoftimin parakualifikues – ose nëse nuk zhvillohet njoftimi parakualifikues – në ftesën për tender, agjencia e zbatimit të projektit detyron ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e ofertës ose së bashku me ofertën deklarimin e sipërmarrjes të nënshkruar rregullisht (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Nëse është e nevojshme, KfW-ja asiston agjencinë e zbatimit të projektit në përzgjedhjen e konsulentit dhe dhënien e kontratës dhe gjatë dhënies së shërbimeve të konsulencës. Detajet përcaktohen në një kontratë të veçantë me agjencinë.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera jepet në bashkëpunim me konsulentin dhe me ofertë ndërkombëtare konkurruese.

3.2 Dokumentet e tenderit i paraqiten KfW-së për komente dhe dhënien e moskundërshtimit në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender.

3.3 Afati i tenderit përcaktohet në një mënyrë që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.4 Detajet e mëtejshme në lidhje me procedurën e dhënies së kontratës dhe dispozitat kontraktuese shpjegohen në “Udhëzimet për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punimeve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 5), që përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Në njoftimin parakualifikues ose – nëse nuk zhvillohet njoftimi parakualifikues – në dokumentet e tenderit, agjencia e zbatimit të projektit i detyron ofertuesit për të paraqitur së bashku me dokumentet parakualifikuese ose së bashku me ofertën një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 5, faqe 27).

3.6 Gjatë lidhjes së kontratave për mallra dhe shërbime që financohen nga huaja, agjencia e zbatimit të projektit respekton gjithashtu parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse asnjë taksë importi nuk financohet nga huaja në pajtim me nenin 1.3 të Marrëveshjes së huasë dhe projektit, këto taksa importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, shprehen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse është ligjërish e zbatueshme në pajtim me legjislacionin shqiptar, zbatohet sa më poshtë: nëse pagesat për tu paguar sipas kontratave të mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata përfshijnë një dispozitë që përcakton se çdo rimbursim, garanci ose pagesë tjetër e ngjashme e kërkuar dhe çdo pagesë siguracioni bëhet për llogari të agjencisë së zbatimit të projektit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) në KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën vendase, ato dërgohen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të projektit në vendin e agjencisë së zbatimit të projektit, që mund të tërhiqen vetëm me pëlqimin e kfw-së. këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e projektit me pëlqimin e KfW-së.

3.7 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i paraqitet për komente projekt kontrata siç është rënë dakord, e paraqitur rregullisht me pëlqimin e konsulentëve. E njëjta zbatohet për çdo marrëveshje të mëvonshme ndryshuese ose modifikuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 OST do të përftojë të drejtat e përdorimit të rrugës dhe të tokës të nevojshme për masat e ndërtimit (ngritja e shtyllave të tensionit të lartë si dhe ndërtesat për mekanizmat e thikave) nga pronarët/zotëruesit sipas një procedure në pajtim me të drejtën shqiptare dhe do të paguajë menjëherë çdo zhdëmtim përkatës për palët e prekura. Konsulenti do të këshillojë OST-në sipas rastit dhe do t'i raportojë KfW-së në lidhje me respektimin e procesit të rregullt të ligjit.

4.2 Gjatë zbatimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit do të kryejë një studim të impaktit mjedisor mbi bazën e kuadrit rregullator përkatës shqiptar dhe rregulloreve të BE-së dhe do të zbatojë projektin në këtë kuadër. Në rast se standardet e brendshme devijojnë në thelb nga rregulloret e BE-së dhe këto devijime kanë një ndikim mbi zbatimin e projektit, mospërmbushja e rregulloreve të BE-së kërkon një deklaram shpjegues të arsyeshëm dhe të justifikueshëm.

Konsulenti do të këshillojë agjencinë e zbatimit të projektit nëse është e nevojshme dhe do t'i raportojë KfW-së mbi saktësinë e procedurës.

4.3 Organi rregullator i brendshëm ERE është përgjegjës për të përcaktuar tarifat e rrjetit të transmetimit që agjencia e zbatimit të projektit do t'ia kërkojë përdoruesve të rrjetit. Me qëllim që të marrim një tarifë bazë të përshtatshme në pajtim me metodologjinë shqiptare për tarifat, agjencia e zbatimit të projektit do të depozitojë aplikimet e tarifave dhe do të diskutojë modifikimet e tarifave me bazë vjetore me ERE në kohën e duhur, që i mundësojnë asaj të përmbushë detyrimet e saj për shlyerje sipas nenit 2.1 në bazë të Marrëveshjes së huasë dhe projektit dhe të kapitalizojë sendet pasurore të financuara sipas huasë jo më vonë se dorëzimi provizor i atyre sendeve pasurore ose në një datë të mëparshme të mundshme. Agjencia e zbatimit të projektit do të informojë KfW-në çdo vit mbi aplikimin e tarifave vjetore për ERE dhe mbi statusin e kapitalizimit të sendeve pasurore të financuara sipas projektit para njoftimit të ERE-s.

4.4 Agjencia e zbatimit të projektit do të kontribuojë për ngritjen e Zyrës së Ankandit të Bashkërenduar (CAO) ose një mekanizmi transparent për alokimin e kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar të energjisë elektrike të një përshtatshmërie të ngjashme, dhe merr pjesë në të pasi të jetë ngritur CAO.

5. Dispozitat për operimin e përshtatshëm të projektit

Për të garantuar operimin e përshtatshëm të projektit, agjencia e zbatimit të projektit paraqet një koncept për operimin dhe mirëmbajtjen të hartuar në bashkëpunim me konsulentin të paktën 6 muaj para autorizimit të projektit.

Në të njëjtën kohë, agjencia e zbatimit të projektit i paraqet KfW-së dhe Huamarrësit një parashikim financiar, të hartuar në bashkëpunim me konsulentin, për fushën e operimit ku gjendet projekti. Ky parashikim është për të treguar që është siguruar financimi i operimit të projektit. Agjencia e zbatimit të projektit përditëson në mënyrë periodike këtë parashikim dhe siguron që çdo

boshllëk financimi të mbulohet në kohën e duhur. Agjencia e zbatimit të ligjit ia transmeton këtë parashikim financiar dhe versionet e tij të rishikuara KfW-së dhe Huamarrësit pa vonesë.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që financohen nga Huaja përgatitet mbi bazën e kontratave të lidhura për këto mallra dhe shërbime. Për pasojë, KfW-së i jepet origjinali ose një kopje e secilës prej kontratave dhe e çdo kontrate ndryshuese përkatëse.

1.2 Nëse një masë e projektit duhet të zbatohet pa kontratë paraprake, KfW-ja merr, në vend të kontratave, një grafik të masave të planifikuara, të detajuara në kategoritë kryesore të kostos (grafiku i masave pa kontratë paraprake). Kostot e shkaktuara për administrimin e përgjithshëm në lidhje me punimet pa kontratë paraprake nuk duhet të përfshihet në grafikun përkatës të masave pa kontratë paraprake.

1.3 KfW-ja informon me kërkesën e agjencinë e zbatimit të projektit për shumat e huasë që ajo ka rezervuar për financim (lista e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregulloret sipas përcaktimit në aneksin nr 6 (procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Në referim të nenit 3.1 të Marrëveshjes së huasë dhe projektit kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjes së huasë dhe projektit bëhen gjithmonë vetëm njëkohësisht me kërkesat e disbursimit sipas marrëveshjeve plotësuese të huasë dhe janë të vlefshme vetëm nëse shumat e kërkuara të disbursimit përputhen me përqindjen e mëposhtëm: 77% (me fjalë: shtatëdhjetë e shtatë për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjes së huasë dhe projektit deri në 37,750,000 ndërsa pjesa e mbetur prej 23% (me fjalë: njëzet e tre për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të huasë duhet të parapaguhet sipas marrëveshjeve plotësuese të huasë. Kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë (10,750,000 euro dhe 500,000 euro), nga të cilat pjesa e parë disbursohet plotësisht e para.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim tjetër, agjencia e zbatimit të projektit i raporton KfW-së çdo tre muaj mbi ecurinë e projektit (raportet e progresit), duke përfshirë përmbushjen e marrëveshjeve të zbatimit të përcaktuara në seksionin II.4 të kësaj Marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të tjera të përgjithshme të rëndësishme. Raporti përfshin pikat e renditura në aneksin 7. Përveç kësaj, agjencia e zbatimit të projektit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë realizimin e objektivit të përgjithshëm, qëllimit të projektit dhe rezultatet. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të projektit, por të paktën para mbarimit të periudhës së garancisë, Agjencia e zbatimit të projektit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e zbatuara. Raporti i parë mbi gjendjen e punëve paraqitet tre muaj pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huasë dhe projektit. Raportet duhet të jenë marrë nga KfW-ja jo më vonë se 4 javë pas përfundimit të periudhës së shqyrtimit. Raportet kundërfirmoset nga konsulenti.

1.2 Nëse agjencia e zbatimit të projektit ka ngarkuar konsulentin të shkruajë raportin e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, agjencia e zbatimit të projektit komenton mbi raportet ose një aprovimin e përmbajtjes nëpërmjet kundërfirmosjes së raporteve.

1.3 Pas përfundimit të projektit, agjencia e zbatimit të projektit raporton mbi zhvillimin e saj të mëtejshëm (shih aneksin 7 për detaje). KfW-ja informon në kohën e duhur agjencinë e zbatimit të projektit mbi përfundimin e periudhës së raportimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Agjencia e zbatimit të projektit i dërgon KfW-së të gjitha ato dokumente që janë të nevojshme për KfW-në të bëjë komente dhe japë aprovimet e përmendura më sipër ose në udhëzimet e bashkëlidhura sa më shpejt për të dhënë kohë të arsyeshme për shqyrtim.

2.2 Agjencia e zbatimit të projektit do të vendosë tabela të Projektit që do të përmbajnë të paktën mesazhin e mëposhtëm:

"Një projekt zhvillimi i Republikës së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së".

Një vulë projekti e dhënë nga ambasada gjermane do të vendoset mbi tabelën e projektit.

2.3 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me

marrëveshje reciprokë nëse kjo do të shfaqet e dobishme për zbatimin e projektit ose zbatimin e Marrëveshjes së huasë dhe projektit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e nenit 7.3 dhe 9 të Marrëveshjes së huasë dhe projektit zbatohen përkatësisht për këtë Marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin tuaj për Marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në një formë ligjërish të detyrueshme dhe duke kthyer kopjet e bashkangjitura.

Jeni të lutur t'i paraqisni konsulentit në kohën e duhur një kopje të kësaj letre.

Juaji sinqerisht,
KfW

Anekset	
Aneks 1:	Objektivat dhe rezultatet e projektit dhe përgjegjësitë për arritjen e tyre
Aneks 2:	Grafiku kohor
Aneks 3:	Kostoja e përgjithshme dhe financimi
Aneks 4:	Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim
Aneks 5:	Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punimeve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim
Aneks 6:	Procedura e disbursimit
Aneks 7:	Përmbajtja e forma e raportimit

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë, ____ dhjetor 2009

Për agjencinë e zbatimit të projektit

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Njohur nga:

Për Huamarrësin, përfaqësuar nga Ministria e Financave

ANEKSI 1

Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

Detajet e projektit

Objektivi i përgjithshëm Fuqizimi i një zhvillimi të qendrueshëm të Shqipërisë së Jugut me një furnizim elektriciteti të përmirësuar dhe një kontribut pozitiv në mbrojtjen e klimës	Treguesit për objektivin e përgjithshëm Ne e marrim në konsideratë kontributin në synimin kryesor të projektit, nëse objektivi i projektit është arrirë.
---	---

Supozime për arritjen e objektivave të përgjithshme

Objektivi i projektit Përmirësimi cilësor dhe sasior i furnizimit me energji Shqipërinë e Jugut dhe reduktimi i dëmtimeve mjedisore lokale dhe globale	Treguesit për objektivin e projektit Themelimi i kapacitetit të transmetimit të energjisë prej 130 MV në Shqipërinë e Jugut, me një disponueshmëri vjetore prej se paku 98%. Përmirësimi i profilit të vo100 Itazhit nëpërmjet një reduktimi të devijimeve nga norma 21 % e linjës 110 kV në maksimumin prej 5%. Reduktimi i nxjerrjes së CO₂ prej deri në 10 000 t CO₂ në vit, nëpërmjet një reduktimi të humbjeve të transmetimit nga 8% në 2%.
--	--

Supozime për arritjen e objektivave të projektit

Furnizimi i mjaftueshëm me elektricitet në Shqipërinë e Jugut.

Tarifat dhe pagesat e transmetimit për konsumatorët rriten për një afat të mesëm dhe me një nivel reflektues të koston.

Personeli i kualifikuar mbetet në OST dhe pajisjet mirëmbahen siç duhet.

Rezultati 1 Eshtë gati për operim një linjë e re 110 kV nga Babica në Sarandë.	Rezultati 2 Himara dhe Orikumi janë lidhur me rrjetin kombëtar të transmetimit secila nëpërmjet linjave të degëzuara	Rezultati 3 Eshtë gati për operim një linjë e re 110 kV nga Erseka në Përmet	Rezultati 4 Janë gati për operim: Një linjë e re 110 kV nga Korça në Ersekë dhe një linjë e re 110 kV nga Përmeti- Këlcyrë dhe Memaliaj.	Rezultati 5 Janë përforcuar një transformator 400/110 kV në Zemlak dhe një linjë 110 kV Zemlak- Korçë.
--	--	--	---	--

- Ndërtimi i linjës 110 kV nga Babica në Sarandë	- Ndërtimi i një linje 110 kV të lidhur me linjën e re 110 kV Babicë-Sarandë (shiko rezultatin 1)	- Ndërtimi i linjës së re 110 kV Përmet-Ersekë	- Ndërtimi i një linje të re 110 kV Korçë- Ersekë dhe shkatërrimi i linjës së vjetër	- Rehabilitimi Shtrirje nënstation Zemlak
--	---	--	--	---

- Përmirësimi i
nënstacioneve në
Babicë dhe Sarandë

- Rikonfigurimi i
rrjeteve shpërndarës
në Himarë dhe
Orikum

Shtrirje e
nënstacioneve në
Përmet-Ersekë

- Shtrirje e nënstac.
Korçë, Këlcyrë
Memaliaj

- Ndërtim i linjës së
re 110kV Zemlak-
Korçë, lëndë
ekzistuese

- Ndërtimi i linjës së
re 110 kV Përmet-
Këlcyrë-Memaliaj
dhe shkatërrim i të
vjetrës

Masat e kërkuara për më shumë se një rezultat
Tenderimi i linjave, izolatorëve, lëndëve, bazamenteve etj.

Supozime për arritjen e rezultateve Njësia e Zbatimit të Projektit siguron kontributin e saj plotësisht dhe në kohë.

GRAFIKU KOHOR I PROJEKTIT

[illegible]

ANEKSI 3
LINJA UNAZORE 110-KV E SHQIPERISE SE JUGUT
KOSTOJA E PERGJITHSHME DHE FINANCIMI

Linja unazore 110-kV e Shqiperise se Jugut			Kostot totale	Kostot lokale	Kostot e jashtme	Financimi FC	Kontributi i OST
Komponenti I							
Pos.	Vleresime te kostove		Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro
1	110kV Babice-Sarande	90km	0.0				
	Percjelles				3.3	3.3	
	Izolator				0.6	0.6	
	Shtylla			3.7		3.7	
	Themel			1.2		1.2	
	Te ndryshme (mbikqyrje, instalime, pjese nderimi)			2.1		1.7	
	Shtrirje e SarandeSS + Babice SS						0.4
	Pajisje HV				0.6	0.6	
	Punime te themelimit			0.2			0.2
	nentotali 1.1		11.7	7.2	4.5	11.1	0.6
	Himare SS + Orikum SS						
	Pajisje HV				5.4	5.4	
	Punime te themelimit			0.3			0.2
	nentotali 1.2		5.6	0.3	5.4	5.4	0.2
	Lidhja/ rikonfigurimi i rjetit shperndares ne Himare + Orikum		2.7				
	Materiale MV				1.0	1.0	
	Materiale LV			1.1		1.1	
	OHL			0.5		0.5	
	Te ndryshme (mbikqyrje, instalime, pjese nderimi)			0.3		0.1	0.2
	nentotali 1.3		2.9	1.9	1.0	2.7	0.2
Totali (investime) i Komponentit I			20.2	9.4	10.9	19.2	1.0
Kontigjenca, rritje cmimi i lendeve te para, pjeseve te nderimit, etj.				0.5	3.0	3.5	
Konsulence					1.9	1.9	
Totali i komponentit I			25.6	9.8	15.8	24.6	1.0
Totali i pergjithshem i komponentit I			25.6				
Komponenti II							
Pos.	Vleresime te kostove		Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro	Mio.Euro
2	110kV LT Erseke-Permet	36km					
	Percjelles				1.2	1.2	
	Izolator				0.2	0.2	
	Shtylla			1.3		1.3	
	Themel			0.7		0.4	0.3
	Te ndryshme (mbikqyrje, instalime, pjese nderimi)			0.5		0.5	
	nentotali 2.1		3.9	2.5	1.4	3.6	0.3
	Shtrirje e nenstacioneve Erseke dhe Permet		0.0				
	Pajisje HV				1.7	1.7	
	Punime te themelimit			0.7		0.6	0.1
	nentotali 2.2		2.4	0.7	1.7	2.3	0.1
3	110kV LT e Re Korce Erseke + cmontimi i linjes se vjeter	36.1km					
	Percjelles				1.25	1.25	
	Izolator				0.25	0.25	
	Shtylla			1.4		1.40	
	Themel			0.5		0.25	0.25
	Te ndryshme (mbikqyrje, instalime, pjese nderimi)			0.7		0.80	
	nentotali 3.1		4.15	2.6	1.50	3.90	0.25
	Shtrirje e nenstacionit ne Korce + punime te rehabilitimit te nevojshme						
	Pajisje HV				0.40	0.40	
	Punime te themelimit			0.5		0.20	0.30
	nentotali 3.2		0.9	0.5	0.40	0.60	0.30
4	110kV LT e Re Permet-Kelcyre + cmontimi i linjes se vjeter	43km					
	Percjelles				1.50	1.50	
	Izolator				0.50	0.50	

		Shtylla			1.7		1.70	
		Themel			0.6		0.60	
		Te ndryshme (mbikqyrje, instalime, pjese nderimi)			0.6		0.30	0.30
		nentotali 4.1		4.9	2.9	2.00	4.60	0.30
		Shtrirje e nenstacionit ne Kelcyre dhe Memaliaj + punime te rehabilitimit te nevojshme						
		Pajisje HV				1.70	1.70	
		Punime te themelimit			1.0		0.70	0.30
		nentotali 4.2		2.7	1	1.70	2.40	0.30
5		Krah transformatori ne Zemblak 400 kV	1					
		Pajisje HV				0.7	0.7	
		Punime te themelimit			0.2		0.2	
		Krah transformatori ne Zemblak 110 kV	1					
		Pajisje HV				0.3	0.3	
		Punime te themelimit			0.1		0.1	
		Transformator energjie 150 MVA -400/110 Kv						
		Pajisje HV				1.3	1.3	
		Punime te themelimit			0.6		0.6	
		Instalimi i qarkut te dyte ne linjen ekzistuese te transmetimit 110kV Zemblak-Korce	13 km		0.3	0.2	0.5	
		Punime te lidhura me nenstacionin 400/110 kV Zemblak, SCADA, OPGW, RTU, instalime telecom etj.	set		0.2	0.3	0.3	0.2
		nentotali 5		4.2	1.4	2.8	4	0.2
		Totali i madh i komponentit II (investime)		23.1	11.6	11.5	21.4	1.7
		Kontigjenca, rritje cmimi i lendeve te para, pjeseve te nderimit, etj.	11%	2.4	0.4	2	2.4	
		Konsulenca	3%	0.6		0.6	0.6	
		Totali i komponentit II		26.1	12	16.1	24.4	1.7
		Totali i pergjithshem i komponentit II		26.1				
Linja unazore 110-kV e Shqiperise se Jugut				Kostot totale	Kostot lokale	Kostot e jashtme	Financimi FC	Kontributi i OST
		Totali i pergjithshem komponenti I+II		51.7	21.8	29.9	49.00	2.7

LINJA UNAZORE 110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR
ME VENDET NË ZHVILLIM

Jeni të lutur t'i referoheni:

http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf

ANEKSI 5
LINJA UNAZORE 110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT
UDHËZIME PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE TË

PUNIMEVE SIPAS BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

Jeni të lutur t'i referoheni:

http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_E_05_2007.pdf

ANEKSI 6
LINJA UNAZORE 110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT
PROCEDURA E DISBURSIMIT

Jeni të lutur t'i referoheni dosjes së veçantë.

ANEKSI 6
I MARRËVESHJES SË VEÇANTË

Punonjësi përgjegjës: Caroline Möller
Tel: +49 69 7431-3542
email: caroline.moeller@KfW.de

Procedura e disbursimit

Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huasë/financimit/projektit/programit të KfW-së

500 000 euro nga Marrëveshja plotësuese e huasë

Emri i projektit/programit: linja unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

Numri i referencës së KfW-së: 2006 65 505

1. HYRJE

Ky aneks përcakton procedurën e disbursimit për projektin/programin e lartpërmendur. Marrëveshja e veçantë duke përfshirë këtë aneks i ofrohet të gjithë personelit të huamarrësit, marrësit ose agjencisë së zbatimi të projektit/programit (Pala e autorizuar) dhe çdo palë tjetër që është e përfshirë në disbursime.

KfW disburson huatë dhe kontributet financiare të pashlyeshme (Fondet) me kërkesë të palës së autorizuar në pajtim me progresin e projekteve/programit të financuara nga KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktues të fondeve që ajo ka rezervuar për mallra dhe shërbime të caktuara mbi bazën e “Marrëveshjes së veçantë” që i përkasin Marrëveshjes së huasë/financimit/projektit/programit. Lista e mallrave dhe shërbimeve si dhe fondet përkatëse të rezervuara nga kuadri brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja pasi të jenë përmbushur të gjitha parakushtet për disbursimin.

2. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

2.1 Të gjitha kërkesat për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;
- numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe
- nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar kundrejt KfW-së dhe nga të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e firmave (shembull shih shtojcën A).

2.2 Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesat origjinale për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë, të shënuar më pas si konfirmim faksi. KfW-ja përjashtohet nga pala e autorizuar nga përgjegjësia për çdo dëm që rrjedh nga transmetimet e pasakta, veçanërisht për shkak të gabimeve në transmetim, abuzimit, keqkuptimit ose gabimeve.

2.3 Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme nga ajo e parashtruar (Monedhë e huaj), KfW-ja debiton huamarrësin ose marrësin me ato shuma që janë shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

2.4 KfW-ja nuk është përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transferuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, përgjegjësia e saj kufizohet me pagesën e interesit të mbledhur.

3. DISPOZITA TË VEÇANTA

3.1 Pala e autorizuar është Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

3.2 Procedura që do të zbatohet

Fondet e caktuara për shërbimet e konsulencës dhe inxhinierike të përcaktuara në Marrëveshjen e veçantë I.1.+1.3 disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e mbetura të caktuara për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në Marrëveshjen e veçantë I.1.+1.3 disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

3.3 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (Konsulenti)

Për pagesat paraprake dhe të përkohshme konsulenti i paraqet faturat e tij KfW-së duke cituar numrin e referencës 2006 65 505 dhe duke i dërguar një kopje palës së autorizuar. Për pagesën përfundimtare, pala e autorizuar do të marrë faturën origjinale dhe dërgojë një kopje së bashku me një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht KfW-së duke përdorur një formular standard të KfW-së (shih shtojcën B).

3.3.1 Dokumentet në mbështetje të kërkesës për tërheqje, sipas rastit:

- Kopje e faturës së konsulentit;
- Prova për bazën e parashikuar në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e rritjes së

çmimit;

- Lista e shpenzimeve për koston e riimbursueshme që tregon datën, përshkrimin, çmimin, normën e këmbimit të shpenzimeve, të nënshkruar rregullisht nga konsulenti që tregon që informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

3.3.2 Dokumente

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që përputhen me faturat duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave të financuara dhe duhet të jenë të aksesueshme në çdo kohë për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh. auditues) ose i dërgohen me kërkesë KfW-së ose palëve të treta të autorizuar nga KfW-ja.

3.4 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një kërkesë për tërheqje të nënshkruar rregullisht (nënshkrime të autorizuar) (shih shtojcën C), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet për pagesë (detajet e plota bankare).

3.4.1 Dokumentet që mbështesin kërkesën për tërheqje, sipas rastit:

Në bazë të procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë pala e autorizuar duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme në kërkesën për tërheqje, sipas rastit:

- Kopje të faturave tregtare për mallrat dhe shërbimet që do financohen. Faturat duhet të përpilohen në pajtim me specifikimet e përcaktuara në kontratat për mallrat dhe/ose shërbimet.

Përveç kësaj, në rastin kur nuk është kontraktuar asnjë konsulent zbatimi dhe është faturuar rritja e çmimit:

- prova për bazën e parashikuar në kontratë për llogaritjen e çmimit.

- Kopje të faturave të ngarkesës nëse tarifat e transportit janë gjithashtu për tu paguar dhe nuk janë përfshirë në shumën e kontratës ose nëse paguhet me koston faktike.

- Për furnizimet nga jashtë shtetit, kopje të dokumenteve të transportit (p.sh. fatura e ngarkesës me anije, faturën e transportit, faturën e transportit ajror), duke deklaruar emrin dhe flamurin e anijes ose tipin dhe shtetësinë të çdo mjeti tjetër transporti, llojin dhe sasinë e mallrave të transportuara si dhe vendin dhe datën e dërgimit.

- Sipas rastit, kopje të garancive bankare dhe të certifikatave të pranimit duhet të jepen në pajtim me kontratën për mallrat dhe/ose shërbimet dhe certifikatat mbi progresin e projektit.

- Një konfirmim mbi faturë nga konsulenti i kontraktuar në zbatimin e projektit, që deklaroi

- që mallrat dhe shërbimet e faturuara janë dhënë rregullisht dhe pagesa e tyre është për tu paguar;

- të gjitha dokumentet që paraqiten (duke përfshirë garancitë) janë në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloret dhe standardet e KfW-së,

- që të gjitha parakushtet për zbatimin e klauzolës së rritjes të çmimit janë përmbushur dhe rritja e çmimit të faturuar është justifikuar.

3.5 Njoftimet e debisë shpërndahen menjëherë tek marrësit e Marrëveshjes së veçantë dhe tek palët e tjera të angazhuara që i komunikohen KfW-së nga pala e autorizuar.

3.6 Në pajtim me nenin 3.1 të Marrëveshjes së huasë dhe projektit kërkesat e disbursimit sipas Marrëveshjes së huasë dhe projektit bëhen në çdo kohë vetëm njëkohësisht me kërkesat e disbursimit sipas marrëveshjeve plotësuese të huasë dhe janë të vlefshme vetëm nëse shumat e kërkuara të disbursimit përputhen me përqindjen e mëposhtme: 77% (me fjalë: shtatëdhjetë e shtatë për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të Huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjes së huasë dhe projektit ndërsa pjesa e mbetur prej 23% (me fjalë: njëzet e tre për qind) e shumës së plotë të disbursimit të huasë sipas Marrëveshjeve të huasë duhet të parapaguhet sipas Marrëveshjeve plotësuese të huasë. Kjo e fundit përbëhet nga dy pjesë (10,750,000 euro dhe 500,000 euro), nga të cilat pjesa e parë e përmendur disbursohet plotësisht e para.

Jeni të lutur të kontaktoni punonjësën e KfW-së të përmendur më sipër nëse keni pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

- A) Shembull i një letre për caktimin e nënshkruesve të autorizuar
- B) Formular kërkesë për tërheqje konsulentët e procedurës së disbursimit të drejtpërdrejtë
- C) Formular kërkesë për tërheqje procedurë e disbursimit të drejtpërdrejtë

SHTOJCA A

SHEMBULL I NJË LETRE PËR CAKTIMIN E NËNSHKRUESVE TË AUTORIZUAR

Nga: _____

Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huasë/financimit/projektit/programit

Drejtuar:

KfW Bankengruppe

Attn: L3a3

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi financiar gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huasë/financimit/projektit të KfW-së

500 000 euro nga Marrëveshja plotësuese e huasë

Emri i projektit/programit: linja unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut

Numri i referencës së KfW-së: 2006 65 505

I dashur Zotëri/Zonjë,

Në lidhje me Marrëveshjen e huasë/financimit/projektit/programit për projektin/programin e përmendur më sipër, do të donim t'ju informonim që cilido nga personat, ekzemplarët e firmave të certifikuar të të cilëve janë në këtë letër, autorizohet të nënshkruajë kërkesat për tërheqje në emër të huamarrësit/marrësit/agjencisë së zbatimit të projektit/programit.

a) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i firmës: _____

b) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i firmës: _____

c) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari i firmës: _____

Të gjitha njoftimet e mëparshme (nëse ka) që japin firmat e punonjësve të autorizuar të nënshkruajnë kërkesat për tërheqje sipas këtij kontributi huaje/financiar anulohen.

Juaji sinqerisht,

Firma e përfaqësuesit të autorizuar sipas Marrëveshjes së huasë/financimit/projektit/programit

Date

Shënim. Në rastin që një kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës, autorizimi duhet ta shprehë këtë qartë. Nëse nënshkruesit e autorizuar ndahen në dy grupe, dhe kërkohet firmë e përbashkët, kjo gjithashtu duhet të shprehet qartë.

SHTOJCA B

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë).

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Lënda.: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huasë/financimit/projektit të KfW-së
500 000 euro nga Marrëveshja plotësuese e huasë
Emri i projektit/programit: linja unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
Numri i referencës së KfW-së: 2006 65 505

Nr. kërkesës së tërheqjes
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave ju janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhet:

Nr i artikullit.*	Kontrata e konsulencës datë me	Fatura e konsulentit nr. datë	Monedha/shuma)

Në bazë të “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesës për t’u paguar do të bëhen nga kontributi i huasë/financiar, që u kërkojmë të disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

•

* Artikull i “Listës së mallrave dhe shërbimeve”

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....
Nr. llogarisë:.....IBAN (sipas rastit)

Emri i bankës:.....Kodi BIC:

Banka korrespondente:*)..... Kodi BIC:
.....

Si provë mbështetëse, një kopje e faturës përkatëse është bashkangjitur, sipas rastit, së bashku me provat për bazën e parashikuar në kontratë për rritjen e çmimit, listën e shpenzimeve për artikujt e riimbursueshëm.

Ne presim njoftimet tuaja të debisë për disbursimet e bëra nga ju.

.....
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

*) Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesat e veçanta kërkohen për çdo monedhë të kërkuar.

SHTOJCA C

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe
 TM a
 Postfach 11 11 41
 60046 Frankfurt am Main
 Federal Republic of Germany

Lënda.: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
 Marrëveshja e huasë/financimit/projektit të KfW-së
 500 000 euro nga Marrëveshja plotësuese e huasë
 Emri i projektit/programit: linja unazore 110-kV e Shqipërisë së Jugut
 Numri i referencës së KfW-së: 2006 65 505

Nr. kërkesës së tërheqjes
 Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat e përcaktuara më poshtë, kopje të të cilave ju janë paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Nr i artikullit.*	Kontrata për mallrat/shërbimet datë me ose grafikun e masave (punimet pa kontratë paraprake) datë	Faturë nr. datë ose grafikun datë	Shuma

Në pajtim me “Listën e mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave për t’u paguar do të bëhen nga kontributi i huasë/financiar, që kërkojmë të disbursohen si më poshtë:

Monedha/shuma	Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)	Numri i llogarisë/IBA, sipas rastit	Banka / kodi BIC	Banka korrespondente*)/ kodi BIC

•

* Artikull i “Listës së mallrave dhe shërbimeve”

--	--	--	--	--

Këto shuma të faturave që nuk paguhen nga kontributi i huasë/financiar janë paguar nga ne si më poshtë:

Monedha/shuma	Përfituesi (shoqëria)	Data e udhëzimit për pagesë dhe banka paguese
.....		
.....		
.....		

Si provë mbështetëse, me paraqesim bashkangjitur – sipas rastit: (jeni të lutur t'i referoheni aneksit të procedurës së disbursimit në Marrëveshjen e veçantë).

- Fatura e konsulentit (sipas termave të pagesës së kontratës)
- faturat e furnizuesit (kopje) për çmimin bazë,
- () që përmban konfirmim nga konsulenti
- Faturat e furnizuesit (kopje) për një rritje çmimi mbi bazën e një klauzole për rritjen e çmimit
- () që ka konfirmimin e konsulentit
- () provë të bazës së llogaritjes
- faturat e ngarkesës (kopje)
- dokumentet e transportit (kopje)
- garancitë bankare (kopje)
- certifikatë pranimi
- certifikata të progresit të projektit
- lista e shpenzimeve (punimet pa kontratë paraprake)
- (.....) që përmban një konfirmim nga konsulenti (sipas rastit)
- dokumente të tjerë:

Ne presim njoftimet tuaja të debisë për disbursimet e bëra prej jush.

.....
(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

*) Përveç kësaj, nëse banka e marrësit të pagesës nuk ndodhet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkesat e veçanta kërkohen për çdo monedhë të kërkuar.

ANEKSI 7

LINJA UNAZORE 110-KV E SHQIPËRISË SË JUGUT

PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTIMIT

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
A. ELEMENTË THELBËSORË DHE AMBIENTI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT	Sipas rastit, tregoni zhvillimin me statistika kronologjike. Shpjegoni të gjitha zhvillimet e veçanta. Vlerësoni ndikimet e tyre mbi suksesin e qëndrueshëm të projektit.	Agjencia e zbatimi të projektit: çdo semestër nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huasë dhe financimit, një vit pas autorizimit: çdo vit

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
1. A ka mbetur agjencia e zbatimit të projektit një operator i aftë?		
- Pasqyrat financiare (llogaritë fitimit dhe humbjes, bilanci, pasqyrat financiare vjetore dhe pasqyrat e të ardhurave mundësisht të certifikuar) - A ka gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm? - A është hyrë në ndonjë fushë të re që nga vlerësimi i projektit? - Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: Veçanërisht Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: (p.sh. shifrat e shitjeve, përdorimi i kapacitetit, norma e rikuperimit të shpenzimeve, humbjet në shpërndarje, kostoja e prodhimit, zhvillimi i tarifave, llogaritë e pashlyera).		
2. A janë zhvilluar kushtet ekonomike dhe sektoriale dhe tregu sipas parashikimit?		
- Roli i konkurrencës dhe dhënësit e shërbimit të rëndësishëm për projektin (zhvillimi i cilësisë, çmimit, qëndrueshmëria, hyrja në treg) - Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale: Të dhëna të tjera në varësi të rasteve individuale (p.sh. zhvillimi rajonal i popullatës, pjesa e tregut, zhvillimi i çmimit të tregut botëror)		
3. A kanë mbetur të pranueshme ndikimet e projektit në ambient? Jeni të lutur të rendisni ndikimet për zbatimin dhe operimin veçmas: - A ka pasur ndryshime në legjislacionin e ambientit me rëndësi për projektin? - A janë dhënë aprovimet që kërkohen nga legjislacioni për ambientin mbi një bazë të besueshme? - A janë përmbushur standardet e ambientit për autorizimin, dokumentet e detajuara inxhinierike, konceptin operativ, planin dhe detyrimet e menaxhimit ambientalist? - A ka pasur ankesa ose padi në lidhje me ndikimet në ambient? - A kanë garantuar kontrollet e parashikuara? - Cilat masa të tjera të mbrojtjes së ambientit janë parashikuar?		
B. GJENDJA E PËRPARIIT DHE GRAFIKU KOHOR		Agjencia e zbatimi të projektit: çdo semestër nga nënshkrimi i Marrëveshjes së huasë dhe financimit deri në pranimin e të gjitha masave të projektit.

Çfarë duam të dimë?	Si duam të informohemi?	Kush raporton? Sa shpesh? Mbi ç'bazë (burim)?
1. Cila është gjendja e ecursisë së projektit si i tillë dhe e aktiviteteve individuale të projektit? Hollësitë mund të jepen në tabela që u bashkëngjiten raporteve: - Caktimi i konsulentit - Dhënia e kontratës, afatet, tipi i shërbimit të dhënë, fuqia punëtore e angazhuar lokalisht dhe në zyrën mbështetëse. -Dhënia e kontratave për shërbimet dhe mallrat - Afatet, marrëveshjet mbi specifikimet, publikimet, rezultati dhe vlerësimi i ofertave, propozimet për dhënien e kontratave, konsultimi mbi kontratat për mallrat dhe shërbimet. - Sjellja e mallrave dhe dhënia e shërbimeve (detajuar sipas listës së përbërësve të projektit ose kontratave të furnizimit) - Mallrat: tipi dhe volume, afatet e furnizimit, garancitë e dhëna, inspektimi përfundimtar nga prodhuesi, pranimi. - Transportet: tipi dhe volume, kohëzgjatja, siguracioni, magazinimi në vendin e ndërtimit. - Punë Ndërtimi: tipi dhe volume, makineria e përdorur, fuqia punëtore e angazhuar, pranimi i punës së ndërtimit. - Punë instalimi: tipi dhe volume, makineria e përdorur, fuqia punëtore e angazhuar, personeli i furnitorëve. - Udhëzime për personelin: tipi dhe objekti, numri, kualifikimi i personeli operativ, trajnimi i avancuar tek furnitori. - Autorizimi: pranimi përfundimtar, provat, rezultatet e operimit, korrigjimet, ngjarjet e garancisë (tipi dhe objekti, pasojat). -Aktivitete të tjera - Studime paraprake, dhëniet, tipi dhe objekti, afatet, personel, material, trajnim i jashtëm, pranim.	Agjencia e zbatimit të projektit/konsulenti regjistron të gjitha masat e parashikuara të projektit dhe kontratat kryesore në pajtim me matricën e informacionit në kolonën B.1. dhe i përditëson ato në çdo raport.	
2. A mund të vihet në operim projekti në momentin e parashikuar?	Përditësimi i aneksit 2 të Marrëveshjes së Veçantë. Krahësim për përmbushjen e objektivave. Shkaqet e shmangieve dhe masat për korrigjimin e tyre. vlerësimi i ndikimit të shmangieve në momentin e komisionit. Vlerësimi i efektivitetit të masave përkatëse korrigjuese. Pasojat financiare dhe të zhvillimit.	
3. A mund të përmbushë detyrat e saj organizata e projektit, veçanërisht në funksionet e bashkërendimit?	Krahësimi për përmbushjen e objektivave të organizatës së projektit. Shkaqet dhe vlerësimi i shmangieve. Cilat masa korrigjuese, sipas rastit janë të nevojshme?	
C. KOSTOJA DHE FINANCIMI I PËRGJITHSHËM	Përditësimi i aneksit 3 të Marrëveshjes së veçantë. Krahësim për përmbushjen e objektivave. Shkaqet për devijimet dhe masat korrigjuese, përveç se kur është shpjeguar sipas B. Pasojat e devijimit në koston e përgjithshme dhe financimin e projektit dhe qëndrueshmëria e tij tregtare.	Agjencia e zbatimit të projektit ose konsulenti: çdo semestër nga ftesa për në tender deri në pranimin përfundimtar.

1. A është i siguruar financimi i projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes?		
2. Sa nga fondet e përgjithshme të projektit dhe të grandit FC (me hollësi) janë përdorur, dokumentuar dhe disbursuar në fund të periudhës nën shqyrtim?		
3. Në cilën shumë janë mbledhur fondet nga interesa të ndryshëm dhe si janë përdorur?		
D. OPERIMI I PROJEKTIT DHE PËRMBUSHJA E PROJEKTIT		Agjencia e zbatimit të projektit ose konsulenti: çdo semestër deri pas 1 viti pas autorizimit, pastaj dy herë në vit, duke filluar nga nënshkrimi i huasë dhe Marrëveshja e financimit.
1. A janë përmbushur përgjegjësitë mbi arritjen e rezultateve, qëllimi i projektit dhe objektivi i përgjithshëm?	Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatë ekzistuese e përshkruar në aneksin 1 në lidhje me rezultatet dhe objektivat. Shkaqet për çdo devijim. Vlerësimi i pasojave të shmangieve mbi suksesin e përshtatshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për përmbushjen e objektivave; vlerësoni efektivitetin e tyre dhe implikimet financiare.	
2. A mund të arrihen rezultatet, qëllimi i projektit dhe objektivi i përgjithshëm? Kur?	Krahasimi ndërmjet situatës faktike dhe situatë ekzistuese e përshkruar në aneksin 1 në lidhje me rezultatet dhe objektivat. Shkaqet për çdo devijim. vlerësimi i pasojave të shmangieve mbi suksesin e përshtatshëm të projektit. Cilat masa duhet të merren për përmbushjen e objektivave; vlerësoni efektivitetin e tyre dhe implikimet financiare.	
3. A ka ndodhur ndonjë zhvillim apo mund të pritët që rrezikon suksesin e qëndrueshëm të projektit (duke përfshirë Cilësinë e raportit ndërmjet agjencisë së zbatimit të projektit nga njëra anë dhe grupin e synuar dhe çdo institucion bashkëpunues ose firmë nga ana tjetër)?	Marrja parasysh e deklarimeve të bëra sipas (A).	
4. A janë bërë të nevojshme masat shtesë? A janë bërë të tepërta aktivitetet e planifikuara të projektit?	Masat e emrave, duke treguar: natyrën, përmbajtjen, kohëzgjatjen, fillimin/fundin, agjencinë përgjegjëse, procedurën e mundshme të prokurimit, koston dhe financimin.	